



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

# **BULETINI**

**I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË**  
**KONKURSIN Nr. 01-26 TË DATËS 01.03.2017**  
**PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK**

## **Fakulteti i FILOLOGJISË**

Programi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

1. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënësi për lëndët: Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji.

Kandidatët:

**1. Dr. sc. Xhafer Beqiraj;**

**2. Dr. sc. Naim Berisha;**

Programi: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

2. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënësi për lëndët: Gramatikë e Gjuhës Gjermane I, Fonetikë e Fonologji dhe Leksikologji.

Kandidatët:

**1. prof. Dr. Izer Maksuti;**

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	19.04.2017
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	02-88/A

### RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

#### Raporti i recensionit

Fakulteti i Filologjisë

Lënda/ët: Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji

Kandidati: Xhafer Beqiraj

#### Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: Xhafer Hysen Beqiraj

Datëlindja dhe vendlindja: 28.04.1970 Dragash

Gradat shkencore: Doktor i shkencave të gjuhësisë

Titujt akademikë: Ka qenë asistent i punësuar pranë UPZ-së

Viti kur është fituar titulli aktual: 2016

Departamenti/fakulteti: Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Universiteti: Universiteti Shtetëror i Tiranës

#### Komisioni recensues:

1. Kryetar Dr. Sabahajdin Cena, prof. i rreg.

2. Anëtar Dr. Naser Pajaziti, prof. i rregullt,

3. Anëtar Dr. Ragip Gjoshi, prof. asistent.

#### Titulli akademik për të cilën shkruhet raporti:

Prof. As.

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

#### Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor *	15	4
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor **	1	1
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor *	2	2
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor **	-	-
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	-	-
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	6	4
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	-	-
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	-	1
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike Ka drejtuar aktivitete letrare në Fakultetin e Edukimit, në Klubin Letrar "Fan S. Noli" dhe në grupet e tjera letare të Sharrit e të Prizrenit.		

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

\***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

\*\***Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

**Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren**  
**Fakulteti i Filologjisë, Prizren**

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

**Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>“Impact factor”</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
1. Adjectivs as word class with nominal and verbal features , Shkodër 2013.	1	
2. Adjectivs as word class with nominal and verbal features , Grin Verlag GmbH, Osnabruck (Deutschland), 2013..		
3. Problems of Gender Accod of Two-Gender Noun Determiners , Grin Verlag GmbH, Munheen, 2014		
4. Valenca e mbiemrit, në “Grin Verlag, Mynhen (Deutschland), 2016. (ISBN 9783656989066)		
5. Një vështrim I shkurtër për valencën dhe rolet tematik të foljes, në Grin Verlag, Munchen (Deutschland), 2016 (ISBN 983656989066).		
<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>pa “Impact factor”</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
1. Funkcionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe (Monografi, tezë doktorate), Tiranë, 2016 ISBN 978-9928-07-441-6)		
2. Probleme të përshtatjes në gjini të përcaktorëve të emrave të dygjinishëm në “Ndihmesa shkencore të Prof. Rami Memushaj”, Triptik, UNI “Ismail Qemali”, Vlorë, 2014.		
3 Çështje të trajtimit semantik të mbiemrave në gramatikat e shqipes, në Konferencës Shkencore “Gjuhë shqipe në 100 vjet Shtet Shqiptar, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë ,2012.		
4. Vështrim mbi sistemin foljor të së folmes së Opojës, Gjurmime albanologjike, IAP, 39/2009, Prishtinë 2009.		
5. Standardet dhe debatet e sotme rreth tij, “Albanologji”, IAP , Prishtinë, 2011.		
<b>Të dhënat për punimet tjera:</b>		

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

1.	Sintagma parafjalore, kumtesë në “Java e Shkencës”, 2012, MASHT, Prishtinë, 2012 (ISBN 978-9951-16-047-6).		
2.	Vështrim lidhur me përshtatjen e disa emrave frymorë me mbiemra e përemra, kumtesat (I), “Java e Shkencës 2013” MASHT, Prishtinë 2013. (ISBN 978-9951-17-055-5).		

### Vërejtje lidhur me tabelën 2:

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së (neni 175, 176 dhe 177). *Punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare* konsiderohen, në radhë të parë, punimet e publikuara në revista me “faktor impakti” e pastaj edhe punimet origjinale të botuara në revistat shkencore ndërkombëtare me “peer review” në lëminë ku konkurren kandidati.

Në këtë tabelë duhen të shënohen vetëm punimet nga fusha e ngushtë shkencore në të cilën kandidati konsiderohet “autor kryesor”. Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi personale lidhur me punimet e radhitura në këtë tabelë Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t’i dorëzohen si dëshmi Komisionit të Studimeve së bashku me raportin e recensionit.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;

2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

Kandidati Xhafer Beqiraj ka punuar si asistent në grupin e lëndëve të gjuhësisë prej vitit 2002 deri në vitin 2005 në kohën kur punohej në këtë institucion si Shkollë e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda”, zotëron për të komunikuar gojazi dhe me shkrim në gjuhën gjermane, në gjuhën serbokroate dhe në gjuhën angleze.

Gjatë punës si asistent, pranë institucionit të përmendur shquhej edhe në veprimtarinë shkencore-hulumtuese duke u marrë me të folmen e Prizrenit dhe të Opojës.

Sot është profesor i angazhuar në Fakultetin e Filologjisë, Dega: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, mban mësim në lëndët fushës së gjuhësisë.

### 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)

- Gjatë një periudhe, si student i ish-Shkollës së Lartë Pedagogjike, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë, shquhej në drejtimin e grupit letrar të shkollës edhe pse punohej në kushtet tejet të vështira nëpër xhamitë e Prizrenit,
- Ishte bashkëpunëtor i ngushtë i udhëheqjes së grupit letrar “Fan S Noli” që vepronte në Prizren,
- Vepronte si bashkëpunëtor në drejtimin e Grupit Letrar “Ymer Prizreni” të Sharrit (ish-Dragashit),
- Pas ndërprerjeve të operacioneve luftarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sërish angazhohet në veprimtaritë e mëparshme edhe si asistent i lëndëve të fushës së gjuhësisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” të Prizrenit, sot Universiteti “Ukshin Hoti”.

Përveç aktiviteteve të përshkruara, kandidati Dr. i sc. Xhaver Beqiraj që shquhej për punë ekipore, zhvilloi edhe një varg aktiviteteve në fushën edukativo-arsimore dhe shkencore-hulumtuese rezultatet e të cilëve ishin të konsiderueshme dhe u çmuan prej studentëve, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### **4. Mobiliteti i kandidatit**

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)*

Kandidati, Dr. i sc. Xhafer Beqiraj, gjatë përpjekjeve të para qëndroi në universitetet austriake të Vjenës, të Lincit e të Klajgenfurtit e pas të gjitha orvatjeve, kthehet në Universitetin e Prishtinës, i përfundon provimet e magjistraturës dhe paraqet tezën e doktoratës në Universitetin Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë ku edhe merr gradën “Doktor i Shkencave të Gjuhësisë” sipas dokumentacionit që ruhet në dosjen e kandidatit dhe në arkivin e Fakultetit të Filologjisë, si e nostrifikuar dhe e protokoluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë më 8 nëntor të vitit 2016, referencë me nr. 6-3098, e nënshkruar nga Drita Kadriu, ndërsa punon si i angazhuar dhe aplikoi në këtë konkurs.

Në vitin 2016, Shtëpia Botuese “Mirgeeralb” e Tiranës kandidatit Xhafer Beqiraj ia botoi monografinë “FUNKSIONET SEMANTIKO SINTAKSORE TË MBIEMRIT NË GJUHËN SHQIPE” recensentë të të cilit janë: Prof. dr. Rami Memushaj dhe Prof. dr. Ragip Mulaku.

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 5. Titulli i cili propozohet

(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).

Komisioni recensues, duke i shqyrtuar dokumentacionet e arritura të pjesëmarrësve të konkursit të datës 1 mars 2017, të regjistruar me numrin e protokollit 01/26, mban përgjegjësi dhe ndjen një kënaqësi të veçantë që për pozicionin e kërkuar "mësimdhënës i rregullt në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për lëndët Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji" ta propozojmë kandidatët:




1. Dr. sc. Xhafer Hysen Beqiraj, të lindur më 28 prill të vitit 1970 në Sharr (ish –Dragash), me vendqëndrim dhe banim në Prizren, në rrugën "Afrim Stajku" nr. 20.
2. Dr.sc. Naim Berisha, i lindur më 22 tetor të vitit 1981 në fshatin Madanaj të Gjakovës,

Rezultojnë meritore

sipas aktiviteteve të deritashme në fushën edukativo-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe krijuese – letrare dhe konsiderohen si të sukseshëm, prandaj edhe i propozohen Këshillit Mësimor-Shkencor të dy kandidatët si të barabartë.

Përzgjedhja dhe propozimi u bënë menjëherë pas tërheqjes së vullnetshme të kandidatit Dr. Asllan Hamiti, sipas shkresës së 7 prillit të vitit 2017, të regjistruar me numrin 104.

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

- |            |                                    |   |
|------------|------------------------------------|---|
| 1. Kryetar | Dr. Sabahajdin Cena, prof. i rreg. |  |
| 2. Anëtar  | Dr. Naser Pajazti, prof. asoc.     |   |
| 3. Anëtar  | Dr. Ragip Gjoshi, prof. ass.       |  |

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

 <p>Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"</p>	
Pranuar me dt. 19.04.2017	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	02-88/B

### RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

#### Raporti i recensionit

Fakulteti: Fakulteti i Filologjisë  
Lënda/ët: Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji  
Kandidati: Naim Brisha

#### Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: Naim Zhel Berisha  
Datëlindja dhe vendlindja: 22 tetor 1981, fshati Madanaj, Gjakovë  
Gradat shkencore: Doktor në gjuhësi  
Titujt akademikë: i angazhuar në Fakultetin e Filologjisë  
Viti kur është fituar titulli aktual: 22 qershor 2016  
Departamenti/fakulteti: Qendra e Studimeve Albanologjike,  
Instituti i Gjuhësisë -Tiranë  
Universiteti: Qendra e Studimeve Albanologjike

#### Komisioni recensues:

1. Kryetar Dr.Sabahajdin Cena, prof. i rreg.
2. Anëtar Dr. Naseer Pajaziti, prof. i rreg.
3. Anëtar Dr. Ragip Gjoshi, prof.ass.

#### Titulli akademik për të cilën shkruhet raporti:

Prof. As.

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

#### Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

<b>Veprimtaria shkencore e kandidatit</b>	<b>Prej fillimit të karrierës</b>	<b>Gjatë 4 vjetëve të fundit</b>
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor *	-	-
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor **	-	-
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor *	-	-
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor **	-	-
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	-	-
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	7	7
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	10	10
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike: Është i punësuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe shquhet me veprimtarinë shkencore-hulumtuese në sektorin e gjuhësisë të këtij Instituti. Merr pjesë në ekspeditat hulumtuese në terren dhe është autor i shumë kumtesave.		

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

**\*Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

**\*\*Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

**Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>"Impact factor"</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
1. The Influence of English Language and the Nature of Linguistic Borrowings in Everyday Speech, XVI Internaacional Conference in Balkan studies, SOfia, Universiteti "St. Kliment Ohridski", 2016.		
<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>pa "Impact factor"</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
Pasqyrimii Konsultës Gjuhësore të Prishtinës në shtypin e kohës në Kosovë, "Perla", Tiranë, nr,3-4/2012.		
2 Overview on Phraseology from Dukagjini Region, "Anglisticum", vol. 4/2015, Oweriev o Phraseology from Dukagjini, Second International Philological Forum, Sofia, Universiteti "St. Kliment Ohridski", 2016.		
3 Fjalët e huaja në medie dhe shqipja e internetit , Seminari VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Prishtinë 2013.		
4. Vështrim mbi frazeologjinë e Rrafshit të Dukagjinit, Seminari VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Prishtinë 2015.		
5. Ndikimi i hershëm i sllavishtes në shqipen sipas Eric P Hamp, Seminari VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Prishtinë 2016.		
6. Vështrim mbi frazeologjin e Rrafshit të Dukagjinit, Seminari VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Prishtinë 2016.		
<b>Të dhënat për punimet tjera:</b>		
1. Studim i rëndësishëm në fushën e leksikut politiko-shoqëror (recension) "Gjuha shqipe", IAP, 2/2009.	-	-
2. Shqipja e internetit dhe Fjalori i "kullësave" Po aty, nr. 1/2010.		
3. Material leksikor nga Gjakova, po aty, nr. 3/ 2011.		
4. Material leksikor nga Gjakova, po aty, nr. 2/2012.		
5. Fjalëformimi me parashtesat dhe prapashtesat në leksikun e Gjakovës		

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

IAP, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike nr.40/2011		
6. Orientalizmat në leksikon e Gjakovës, po aty, nr. 41/2012.		
7. Ndikimi i anglishtes dhe i gjermanishtes në gjuhën shqipe, natyra e huazimeve gjuhsore në folurit e përditshëm, Konferencë, Shqipja e sotme dhe marrëdhëniet e saj me gjuht e tjera, UPZ "Ukshin Hoti", Prizren 2016.		
8. Kongresi i drejtshkrimit në shtypin e Kosovës, "Jeta e Re",2012.		

### Vërejtje lidhur me tabelën 2:

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së (neni 175, 176 dhe 177). *Punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare* konsiderohen, në radhë të parë, punimet e publikuara në revista me "faktor impakti" e pastaj edhe punimet origjinale të botuara në revistat shkencore ndërkombëtare me "peer review" në lëminë ku konkurron kandidati.

Në këtë tabelë duhen të shënohen vetëm punimet nga fusha e ngushtë shkencore në të cilën kandidati konsiderohet "autor kryesor". Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi personale lidhur me punimet e radhitura në këtë tabelë Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t'i dorëzohen si dëshmi Komisionit të Studimeve së bashku me raportin e recensionit.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;

2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

Kandidati Naim Berisha është autor edhe i shkrimeve:

- Fjalët e huaja në medie, Java e Albanologjisë, 1/2010.
- Shqipja përballë ndikimit të anglishtes në përdorimin e përditshëm, Po aty, I/2013.
- Revista “Gjuha shqipe dhe standardet”, po aty, II/2011.
- Kompjuteri (interneti), përparësitë dhe pasojat, Java e shkencës, 2012.
- Leksiku bujqësor dhe blegtoral në rajonin e Gjakovës, Po aty, 2013.
- Frazelogjia në trevën e Gjakovës, Po aty, 2014.
- Shqipja “moderne” në rrjedhat globalizuese, Po aty, I/2014.
- Emërtimi i kafshëve në Gjakovë me rrethinë, QSA, Kërkime gjuhësore, 2012.
- Leksiku mbi pjesët e shtëpisë dhe orenditë shtëpiake në trevën e Gjakovës, QSA, Tiranë 2014.
- Gjashtëdhjetë vjet përpjekje për studimin e gjuhës shqipe në Institutin Albanologjik të Prishtinës, Po aty, 2013.

Po kështu, kandidati Naim Berisha ka në dorëshkrim edhe dy libra:

1. Vëzhgime leksiko-frazelogjike në të folmen e Rrafshit të Dukagjinit, dhe
2. Leksiku dhe frazeologjia në trevën e Gjakovës.

### 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)*

Dr. sc. Naim Berisha u punësua në Institutin Albanologjik të Prishtinës më 1 tetor të vitit 2008 në vendin e punës “Hulumtues i pavarur shkencor” dhe vazhdoi punën e rregullt në këtë institucion shkencor, në Degën e Gjuhësisë. Gjatë vitit akademik 2014/2015 ishte mësimdhënës i angazhuar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit për lëndët: Gjuhë shqipe I, si asistent, Metodologji e gjuhës amtare, si asistent dhe ligjërues për lëndën Kulturë gjuhe. Gjatë vitit 2015/16 angazhohet në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, Fakulteti i Filologjisë si mësimdhënës e asistent për lëndët: Kulturë gjuhe, Filologji shqiptare, Fonetikë dhe Histori e shqipes standare, ndërsa gjatë vitit akademik 2016/17, po këtu angazhohet edhe për lëndët: Filologji shqiptare, Metodologji e gjuhës amtare dhe Etimologji. Gjatë semestrit veror të këtij viti akademik angazhohet sërish për lëndët: Morfologji II, si asistent dhe Sintaksë II, po ashtu asistent.

Në fushën e trajnimeve mbaroi kursin tremujor pasuniversitar për marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci në Akademinë Diplomatike Shqiptare dhe ka aaftësi për marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhim të institucioneve dhe menaxhim të krizave. Zotëron gjuhën shqipe, anglishte dhe gjuhën italiane.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

Aktualisht punon si punëtor i rregullt në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe është i angazhuar si mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

#### **4. Mobiliteti i kandidatit**

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore*

- **Më 5 tetor të vitit 2004, sipas dokumentacionit të Universitetit të Prishtinës, merr kualifikimin “Profesor”,**
- **Më 29 qershor të vitit 2016, sipas dokumentacionit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina, mbron temën e masterit në Shkencat e gjuhësisë,**
- **Më 22 korrik të vitit 2016, sipas dokumentacionit , doktoron në Shkencat gjuhësore, dhe dokumenti është i nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me nr. të referencës 6-3921 të datës 8 nëntor të vitit 2016.**
- **Prej 20 shtatorit deri më 20 dhjetor të vitit 2005 vijon dhe i përfundon studimet në Akademinë Diplomatike Shqiptare në Tiranë.**

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 5. Titulli i cili propozohet

(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).

Komisioni recensues, duke i shqyrtuar dokumentacionet e arritura të pjesëmarrësve të konkursit të datës 1 mars 2017, të regjistruar me numrin e protokollit 01/26, mban përgjegjësi dhe ndjen një kënaqësi të veçantë që për pozicionin e kërkuar “mësimdhënës i rregullt në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për lëndët Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji” ta propozojmë kandidatinët:

1. Dr. sc. Xhafer Hysen Beqiraj, të lindur më 28 prill të vitit 1970 në Sharr (ish –Dragash), me vendqëndrim dhe banim në Prizren, në rrugën “Afrim Stajku” nr. 20.
2. Dr.sc. Naim Berisha, i lindur më 22 tetor të vitit 1981 në fshatin Madanaj të Gjakovës,

Rezultojnë meritore

sipas aktiviteteve të deritashme në fushën edukativo-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe krijuese – letrare dhe konsiderohen si të sukseshëm, prandaj edhe i propozohen Këshillit Mësimor-Shkencor të dy kandidatët si të barabartë.

Përzgjedhja dhe propozimi u bënë menjëherë pas tërheqjes së vullnetshme të kandidatit Dr. Asllan Hamiti, sipas shkresës së 7 prillit të vitit 2017, të regjistruar me numrin 104.

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetar

Dr. Sabahajdin Cena, prof. i rreg.

2. Anëtar

Dr. Naser Pajazti, prof. asoc.


3. Anëtar

Dr. Ragip Gjoshi, prof. ass.

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK



#### Raporti i recensionit

Fakulteti: Fakulteti i Filologjisë

Lënda/ët: *Hyrje në linguistikë gjermane, fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, leksikologji e gjuhës gjermane, gjuhësi kontrastive, seminar i gjuhësisë gjermane, metodologjia dhe teknikat e punës shkencore.*

Kandidatët e paraqitur:

1. Prof. Dr. **Izer Maksuti**

#### Të dhënat e kandidatit të parë:

Emri dhe mbiemri: Izer MAKSUTI

Datëlindja dhe vendlindja: 10.02.1973, Tuhin, Kërçovë, Maqedoni

Gradat shkencore: Mag. Phil (2003), Dr. Phil. 2006 (në Universitetin e Vjenës, Austri; studime në fushë të gjuhësisë, gjermanistikës dhe traslatologjisë 1995-2003)

Titujt akademikë: Profesor i asocuar

Viti kur është fituar titulli aktual: 2013

Departamenti/fakulteti: Fakulteti Filologjik

Universiteti: Universiteti Shtetëror i Tetovës

#### Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof.dr. Brikena Kadzadej, prof. ordinar
2. Anëtar Prof.dr. Emil Lafe, prof. ordinar
3. Anëtar Prof.dr. Mario de Matteis, prof. ordinar

#### Titulli akademik për të cilën shkruhet raporti:

As.                      Profesor Asistent.                      Prof. Asc.                      **Prof. Dr.**

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit Prof. dr. Izer MAKSUTI

#### Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë originalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor *		
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor **		
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor *	4	2
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor **		
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor		
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	9	6
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	8	7
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	2	
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe		
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	1	
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike -		

#### Vërejtje lidhur me tabelën 1:

\***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

\*\***Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

**Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë originalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>“Impact factor”</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
Maksuti, Izer (2015): Internationalismen im Albanischen unter besonderer Berücksichtigung des Alltagswortschatzes. – Meine Sprachen, meine Forschung und ich. SprachwissenschaftlerInnen reflektieren über ihre Arbeit. Festschrift für Rudolf de Cillia. SPRACHE IM KONTEXT, Bd. 43, Wien u.a. Peter Lang, fq. 75-85.		
Maksuti, Izer (2012): Internationalismen und false friends. Die „richtigen“ und die „falschen“ Freunde. – DITURIA: Zeitschrift für Germanistische Sprach- und Literaturwissenschaft (Oberhausen, ATHENA-Verlag), nr. 8, fq. 73-88. – ISSN: 2191-2440		
Maksuti, Izer (2010): Ein kurzer geschichtlicher Überblick der deutschsprachigen Albanologie. – Fachsprache Deutsch (DaF), Interkulturalität und Landeswissenschaft. Hrsg. von Mario de Matteis, Brikena Kadzadej, Jürgen Röhling. Oberhausen: ATHENA-Verlag, Bd. 3, S. 37 – 48. – ISBN: 978-3-89896-392-3		
<b>Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>	<b>pa “Impact factor”</b>	<b>Nr. i citimeve</b>
Maksuti, Izer (2016): Rreth kontributit të hulumtuesve austro-hungarezë për gjuhën shqipe. Shkup: Logos-A. Në shtyp		
Maksuti, Izer (2016): Rreth kontakteve të shqipes me gjuhët tjera – një vështrim i shkurtër. - FILOLOGJIA International Journal of Human sciences, Vol. 4, Nr. 4, Tetova 2016, in Print) ISSN 1857-8535		
Maksuti, Izer (2015): Mbi disa veçori leksikore të gjermanishtes dhe shqipes – Sprovë për një krahasim të dy arealeve gjuhësore. – FILOLOGJIA International Journal of Human sciences, Vol. 3, No. 3, Tetova 2015, fq. 30-47. ISSN 1857-8535		
Maksuti, Izer (2014): Mbi botimet e profesor Fadil Sulejmanit për gjuhën gjermane. Konferencë shkencore kushtuar profesor Fadil Sulejmanit, shkurt 2014, Tetovë. – FILOLOGJIA International Journal of Human sciences, Vol.		

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

2, No. 1-2, Tetova 2014, fq. 51-55. ISSN 1857-8535		
Maksuti, Izer (2014): Kontaktet gjuhësore të shqipes me gjermanishten. - ALBANOLOGJIA, International Journal of Albanology, Vol. 1, No. 1-2, Tetova 2014, fq. 149-154. Botime të Seminarit VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë. ISSN 1857-9485 (Print)		
Maksuti, Izer (2013): Das Albanische. Ein kurzer geschichtlicher Überblick über die Dialekte und die Standardisierung. – FILOLOGJIA revistë shkencore ndërkombëtare për gjuhësi, letërsi dhe kulturë, Tetovë, USHT, Viti I, prill 2013, fq. 411-426. ISSN 1857-8535		
Maksuti, Izer (2013): Ein kurzer geschichtlicher Überblick der deutschsprachigen Albanologie. In: Poeta nascitur, historicus fit - Ad honorem Zef Mirdita, Albert Ramaj (ed.), St. Gallen – Zagreb, (botim i plotësuar e aktualizuar), fq. 849-860. ISBN: 978-3-9524201-0-2		
Maksuti, Izer (2007): Gjermanizmat në gjuhën shqipe. – Gjuha Shqipe (Prishtinë), 3/2007, fq. 56-65		
Maksuti, Izer (2001): Sprachliche Einflüsse des Deutschen auf das Albanische ( <i>Ndikime gjuhësore të gjermanishtes në shqip</i> ). Në: "Dardania" (Vjenë)- Zeitschrift für Geschichte, Kultur, Literatur und Politik, Nr. 11/2001, fq. 273 - 290.		
<b>Të dhënat për punimet tjera:</b>		
Libra shkencore te botuara		
Maksuti, Izer (2010): Sprachliche Einflüsse des Deutschen auf das Albanische: Deutsche Entlehnungen im albanischen Wortschatz. Saarbrücken: VDM. 172 fq. ISBN-13: 978-3639255485		
Maksuti, Izer (2009): Internationalismen im Albanischen. Eine kontrastive Untersuchung unter besonderer Berücksichtigung des Alltagswortschatzes - Albanisch, Deutsch, Englisch, Französisch. Saarbrücken: Südwestdeutscher Verlag für Hochschulschriften. 232 fq. - ISBN-13: 978-3838102993		
Kahl, Thede / Maksuti, Izer / Ramaj, Albert (ed.) 2006: Die Albaner in der Republik Makedonien. Fakten, Analysen, Meinungen zur interethnischen Koexistenz. Wien, Berlin: LIT Verlag. - 296 fq. (Wiener Osteuropa Studien, herausgegeben vom Österreichischen Ost- und Südosteuropa-Institut, Bd. 23) ISBN-13: 978-3825800307		

Vërejtje lidhur me tabelën 2:

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së (neni 175, 176 dhe 177). Punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare konsiderohen, në radhë të parë, punimet e publikuara në revista me “faktor impakti” e pastaj

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

edhe punimet origjinale të botuara në revistat shkencore ndërkombëtare me “peer review” në lëminë ku konkurren kandidatit.

Në këtë tabelë duhen të shënohen vetëm punimet nga fusha e ngushtë shkencore në të cilën kandidati konsiderohet “autor kryesor”. Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi personale lidhur me punimet e radhitura në këtë tabelë Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t’i dorëzohen si dëshmi Komisionit të Studimeve së bashku me raportin e recensionit.

### 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;

2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

Kandidati Izer MAKSUTI ka përvojë të bujshme në mësimdhënie universitare në disa universitete të vendit dhe rajonit. Nis rrugëtimin e tij akademik si **asistent** i gjuhësisë gjermane në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë nga 2003 deri 2007.

Prej prillit 2007 zgjidhet **docent** në Universitetin Shtetëror të Tetovës për lëndë: Gjuhësi gjermane dhe leksikologji e gjuhës gjermane. Prej shkurtit 2009 një semestër është mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, në Studime Master për lëndët: *Modele gramatikore* (Hyrje në gjuhësi) dhe *Histori e gjuhës gjermane*.

Prej Nëntorit 2010 punon si mësimdhënës në Universitet të Prizrenit dhe emërohet profesor i asocuar. Në këtë universitet mban këto leksione: *Hyrje në gjuhësi gjermane, fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, leksikologji e gjuhës gjermane, seminar i gjuhësisë, metodologjia dhe teknikat e punës shkencor*. Prej shkurtit 2013 zgjidhet **Profesor inordinar** në Universitetin Shtetëror të Tetovës; në këtë universitet ofron leksione për lëndët në vijim: *Hyrje në gjuhësi, fonetikë e fonologji gjermane, drejtshkrim I dhe II, leksikologji e gjuhës gjermane I dhe II*. Po ashtu rishtas prej semestrit dimëror 2016 në Universitetin e Evropës Juglindore ofroi lëndën: *Fjalëformim* (gjuhë gjermane), ndërsa në semestrin veror 2017 këtu ofron lëndën: *Përkthim gjermanisht-shqip* dhe për ciklin e dytë – Master lëndën e sociolinguistikës.

### 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitrat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)

Prej janarit 2007 deri në korrik 2009 ai është **shëf** i Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Prej majit 2007 Sekretar shkencor i Seminarit I Albanologjik, Universitetin Shtetëror të Tetovës. Prej korrikut 2009 deri në shtator 2010 është u.d. **Dekan** i Fakultetit Filologjik, USHT. Prej tetorit 2011 deri në korrik 2014 është **shëf** i Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane në Universitetin e Prizrenit. Gjatë kësaj kohe shquhet për menaxhim korrekt, hartim plan-programesh, kooperim me botën gjermanofone, me institucione të njohura si DAAD, Fondacioni Bosch e Herder instalim të programeve lektorale austriake OEAD, në USHT në Tetovë dhe UPZ në Prizren si dhe nxitje për një bashkëpunim të frytshëm trilateral Kosovë-Shqipëri-Maqedoni.

# Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### 4. Mobiliteti i kandidatit

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)*

Kandidati Izer Maksuti, studimet themelore, të magjistraturës dhe të Doktoratës, që të tre nivelet e shkollimit të lartë, i ka përfunduar në Universitetin e Vjenës. Edhe pas studimeve pasojnë vizita studimore në Gjermani e Austri.

Pjesëmarrja në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, siç dëshmohen në tabelën e punimeve të kandidatit, veçojmë këtu:

02.08. – 08.08.2009 - Pjesëmarrës në konferencën XIV ndërkombëtare të mësuesve të gjuhës gjermane në Jena-Weimar, Gjermani  
(„XIV. Internationale Tagung der Deutschlehrerinnen und Deutschlehrer“)

14.08. – 24.08.2009 - Pjesëmarrës në akademinë verore në Sopron/Hungari  
(Sommerakademie des Bosch-Lektorenprogramms in Sopron/Ungarn)

28.01.- 30.01.2010 - Pjesëmarrës në projektin e përbashkët për Bolonjën në Universitetin e Rijekës/Kroaci (Kooperationsprojekt „STAFFELLAUF BOLOGNA SÜDOSTEUROPA“, Robert Bosch Stiftung)

2./3. dhjetor 2011 - Pjesëmarrës në konferencën organizuar nga ÖDaF-Fachverband, Vjenë  
„Ausgesprochen unerhört“ Vom Hören, Sprechen und Klingeln der deutschen Sprache- Der österreichische Fachverband für Deutsch als Fremdsprache/Zweitsprache

11/15 prill 2016 - Pjesëmarrës në „International Week“ në: Pädagogische Hochschule Tirol, Innsbruck, Austri.

Pjesëmarrës në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë (Austrinë), nga mesi i shek. XIX deri në ditët tona”. Prishtinë 9 shtator 2016.

17/18 mars 2017 – Pjesëmarrës në konferencën: “Man lernt nicht mit dem Kopf allein” - Zur Rolle von Emotionen im DaF/DaZ-Unterricht. Në: Pädagogische Hochschule Wien, Vjenë.

### 5. Titulli i cili propozohet

*(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).*

Në përfundim të këtij raporti recensues japim këtë:

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren

### Propozim

Në bazë të asaj që u tha më lart për kandidatin e paraqitur në konkurs dhe në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe me kriteret e konkursit të datës **01.03.2017**, në bazë të vendimit të senatit të këtij universiteti për caktimin e komisioneve recensuese (Nr. i ref. 67, datë 23.03.2017) i propozojmë Këshillit Mësimor të Fakultetit të Filologjisë dhe Senatit të këtij Universiteti që ta zgjedhë kandidatin **prof. dr. Izer Maksuti** mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në thirrjen **Profesor i rregullt** për lëndët: *Hyrje në linguistikë gjermane, fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane, leksikologji e gjuhës gjermane, gjuhësi kontrastive, seminar i gjuhësisë gjermane, metodologjia dhe teknikat e punës shkencore.*

### Arsyetim

Nga përshkrimet e kualifikimeve, publikimeve dhe përvojës së punës, kandidati Prof. Dr. Izer Maksuti i **plotëson kushtet e konkursit dhe propozohet për zgjedhje në thirrjen profesor i rregullt (Prof.Dr.)** në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, për lëndët e shpallura në konkursin e lartëshënuar.

Kandidati Prof. Dr. Izer Maksuti ka përgatitjen e duhur akademike, studimet e larta të tre niveleve, në Universitetin e Vjenës (studimet bazë 1995-2002; magjistratura (2003) dhe studimet e doktoratës, 2003-2006, mentoruar dy herë nga linguisti me renome ndërkombëtare prof. dr. Wolfgang U. Dressler.

Kandidati ka përvojë shumëvjeçare në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë, si mësimdhënës dhe pjesëmarrës në projekte të shumta shkencore. Argument shtesë janë edhe publikimet e shumta, hartimi i studimeve monografike si dhe pjesëmarrja në shumë konferenca shkencore.

Duke u mbështetur në arsyetimet e mësipërme dhe në statusin e Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, neni 174, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, përkatësisht Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, kandidatin Prof. Dr. **Izer Maksuti** ta zgjedhë në thirrjen mësimdhënës në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetar Prof.dr. Brikena Kadzadej, prof. ordinar
2. Anëtar Prof.dr. Emil Lafe, prof. ordinar
3. Anëtar Prof.dr. Mario de Matteis, prof. ordinar

